



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011443/18, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE

Neni 1

86 (tetëdhjetë e gjashtë) personave në gjendje të rëndë sociale dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 7950.00 €.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Nr.02-401/01-0043508/18
Podujevë, 31 maj 2018



Kryetari i Komunës
Agim Veliu